

## KORRUPSION, KONFLIKT INTERESI, PËRGJEGJËSI

### DENONCO!

Askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për arsye të denoncimit të korrupsionit, konfliktit të interesave, parashtrimit të kërkesës për vërtetimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, respektivisht kryetarit të gjykatës ose parashtron parashtrësë.

1. Denonco korrupsionin ose konfliktin e interesit.
2. Parashtro kërkesë për vërtetimin e përgjegjësisë së gjykatësit ose kryetarit të gjykatës.
3. Parashtro parashtrësë.

Korrupsioni dhe konflikti i interesit

Aktivitetet korruptuese të të punësuarve në gjyqësi dhe në Këshillin Gjyqësor denoncohen te Prokuroria Themelore Publike kompetente, me shkrim ose në procesverbal. Denoncimi është më efikas para se të bëhet dorëzimi i përfitimit.

Kur ekziston konflikti i interesit, kërkohet përjashtimi i personit i cili vepron me fakte, dhe nëse ka njohuri se dikush vepron në lëndë në të cilën duhet të jetë i përjashtuar, mund të parashtrohet kërkesë për përcaktimin e përgjegjësisë në Këshillin Gjyqësor, nëse është gjyqtar, ndërsa për pjesëmarrës në procedurë, mund të parashtrohet kërkesë te gjyqtari ose kryetari i gjykatës.

Kërkesa për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, respektivisht të kryetarit të gjykatës

Kërkesë mund të parashtrohet nëse gjyqtari ose kryetari i gjykatës ka kryer shkelje disiplinore ose e kryen funksionin në mënyrë të pandërgjegjshme dhe joprofesionale, dhe ajo duhet të përmban:

- Emrin dhe mbiemrin e gjyqtar/kryetarit të gjykatës dhe gjykatën në të cilën e kryen funksionin si gjyqtar;
- Përshkrimi i arsytuar i shkeljes, emërtimi ligjor i të njëjtës dhe cekja e dispozitave nga Ligji për Gjykata;
- Propozim fakte të cilat duhet të nxiren dhe të njëjtat të dorëzohen;
- Të dhëna për parashtruesin e kërkesës, adresa dhe nënshkrimi.

**Kërkesa dorëzohet** në Këshillin Gjyqësor të RMV, më së voni 6 muaj nga dita e zbulimit të shkeljes, por jo më larg se 3 vjet nga dita e realizimit të shkeljes. Kërkesa për vërtetimin e përgjegjësisë vlerësohet nga Komisioni i Këshillit Gjyqësor të RMV, nëse është në kohë, e plotë dhe nëse nuk është qartazi e pabazuar (nen. 63 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV), dhe nëse nuk refuzohet, vërtetohet përgjegjësia.

**Shiko:** Ligji për Gjykata, nen. 73-79 Gazeta Zyrtare e RMV nr. 58/2006.... 96/19 viti 2019) dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor (G. Zyrtare e RMV nr.102/19)

### **Parashtresa**

Parashtresa parashtrohet për shkak të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave dhe interesave të veta ose për mbrojtje të interesave publike.

### **Parashtresa duhet të përmbajë:**

- për cilin gjyqtar ose kryetar të gjykatës bëhet fjalë;
- për cilën lëndë bëhet fjalë (shembull K.nr.15/20 ose P.1 nr.34/21);
- arsyetim të shkurtër për gjendjen faktike dhe prova;
- emri dhe mbiemri, adresa e banimit të parashtruesit dhe nënshkrim dora vetë (nëse pritet përgjigje nga Gjykata e Apelit).

Parashtresa mund të jetë anonime, por vetëm nëse thekset janë të karakterit publik.  
Këshilli Gjyqësor nuk vepron sipas parashtresave të cilat kanë përmbajtje ofenduese.

Qëllimi i parashtresës është tejkalimi i një problemi të caktuar për shkak të së cilit pala – parashtruesi nuk mund të realizojë një të drejtë të caktuar.

Parashtresat e parashtruara në mënyrë elektronike duhet të përmbajnë nënshkrim elektronik.

Nëse parashtresa parashtrohet në emër të ndonjë personi tjetër, është e nevojshme që të dorëzohet autorizim.

**Shiko:** Ligji për Veprim sipas Parashtresave dhe Propozimeve (G. Zyrtare e RM nr.87/08, 13/2013 dhe 193/150 dhe Rregullorja për mënyrën e veprimiit sipas parashtresave dhe propozimeve (G. Zyrtare e RM 2/2009).